



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 12.3, 64.2 (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës me qëllim të përcaktimit të procedurave të regjistrimit dhe veprimit të partive politike, nxjerr:

**RREGULLËN Nr. 01/2008
PËR REGJISTRIMIN DHE VEPRIMIN E PARTIVE POLITIKE**

Neni 1
Përkufizimet

1.1 Për qëllimin e kësaj Rregulle:

- (a) “Borxhi” do të thotë të gjitha shumatat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t’ua paguaj personave të tjerë.
- (b) “Ditë Pune” do të thotë cilado ditë kalendarike prej të hënës deri të premten, që fillon prej orës 8:00 paradite dhe mbaron në orën 16:00;
- (c) “KQZ” do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;
- (d) “Kontributi” do të thotë dhurata, ndihma ose donacioni i cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo të mira materiale dhe përfshinë pagesën e borxheve të subjektit dhe sigurimin jo në baza komerciale, të pasurisë, të huas, të shërbimeve dhe të objekteve për shfrytëzim ose përfitim të subjektit. Shërbimet që i ofrohen subjektit politik nga individ në mënyrë vullnetare jashtë orarit të tyre të punës dhe pa pagesë nuk konsiderohen kontribute. Kontributi realizohet atëherë kur subjekti politik përfiton nga kontributi;
- (e) “Kuvendi i partisë” do të thotë mbledhje e përgjithshme e të gjithë anëtarëve të partisë politike ose delegatëve të zgjedhur në mënyrë demokratike nga të gjithë anëtarët;
- (f) “Pagesa” do të thotë transferimi i pagesës në vlerë përfshirë edhe pagesën në formë të mallrave dhe shërbimeve. Pagesa bëhet në kohën kur merret përfitimi nga paguesi;
- (g) “Parti politike” do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesave apo pikëpamjeve të tyre të përbashkëta me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në poste publike;

(h) "Pasuria" do të thotë e tërë pasuria e paluajtshme ose e luajtshme në pronë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, përfshirë parat e gatshme në dorë ose depozitat bankare, si dhe të ardhurat që burojnë prej tyre nga shitja, kalimi në posedim të një personi të tretë apo marrëveshje tjetër, vlera e bizneseve në pronësi dhe çdo send në zotërim që ka vlerë më të madhe se pesëqind euro (500) dhe me jetëgjatësi ekonomike më të gjatë se tri (3) vjet;

(i) "Personi kontaktues" do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikojë në emër të partisë politike me Zyrën;

(j) "Përfaqësuesi financiar" do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për të komunikuar me Zyrën lidhur me raportet për deklarimin e financave të subjektit politik;

(k) "Rregull" do të thotë një akt i miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në pajtim me Ligjin;

(l) "Subjekt politik" do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

(m) "Zyrë" do të thotë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim që vepron në kuadër të KQZ-së ashtu siç është e saktësuar me legjislacionin në fuqi;

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Zyra për regjistrim të partive politike dhe certifikim ("Zyra") është përgjegjëse për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar.

2.2 Zyra udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv i cili i raporton drejtpërdrejt KQZ-së.

2.3 Të gjitha partitë politike të regjistruara nga Zyra për regjistrim të partive politike brenda Shtyllës së III-të të UNMIK-ut (OSBE) para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konsiderohen të regjistruara.

2.4 Partia politike që përfshihet në regjistrin e partive politike fiton statusin e personit juridik me zotësi për të pasur pasuri, për të lidhur kontrata, për të paditur dhe për tu paditur në emër të saj.

2.5 Partitë politike duhet të aplikojnë për të vazhduar regjistrimin çdo vit jo më vonë se 31 marsi vitit kalendarik.

2.6 Kërkesat për regjistrimin e partive politike mund të dorëzohen në Zyrë në çdo kohë, prej të hënës deri të premtën gjatë orëve të rregullta të punës.

Neni 3

Regjistrimi i partive politike

3.1 Partia politike mund të paraqitet për regjistrim duke ia dorëzuar zyrës:

(a) formularin e plotësuar të kërkesës për regjistrimin e partisë politike, i cili është bashkëngjitur si shtojca (1);

- (i) emrin zyrtar, akronimin dhe simbolin e partisë politike që është paraqitur për regjistrim;
 - (ii) emrin, mbiemrin, adresën, numrat e telefonit të kryetarit të partisë dhe anëtarëve të kryesisë së saj;
 - (iii) emrat, mbiemrat adresat dhe numrat e telefonit të përfaqësuesve të partisë që është paraqitur për regjistrim në çdo komunë në të cilën partia është aktive.
 - (iv) emrin, mbiemrin, adresa dhe numri i telefonit të kontakt personit të partisë politike me Zyrën;
 - (v) emrin, mbiemrin, adresa dhe numri i telefonit të përfaqësuesit financiar të partisë politike;
 - (vi) numrin e telefonit dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;
- (b) statutin e partisë në përputhshmëri me nenin 12 të kësaj Rregulle;
- (c) dokumentin e themelimit i cili përfshinë;
- (i) datën dhe vendin e themelimit të partisë dhe
 - (ii) emrat e të nënshkruarve si anëtarë themelues të partisë
- (d) Së paku pesëqind (500) nënshkrime të votuesve të regjistruar që mbështesin partinë politike në mënyrën e përshkruar nga Zyra së bashku me emrin, datën, numrin personal të dokumenteve valide në Kosovë, vendlindjen dhe adresën e çdo nënshkruesi, i cili është bashkëngjitur si shtojca (2).
- (e) Programin politik të partisë që është paraqitur për regjistrim të miratuar nga organi i saj më i lartë, ku paraqiten objektivat politike dhe aktivitetet e partisë.
- (f) Taksën e pakthyeshme për regjistrim prej 500 (pesëqind) euro.
- (g) Deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'u përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike,
- (h) Deklaratën e fundit financiare të partisë.

3.2 Për ndryshimet sa i përket kryetarit apo zyrtarit për financa të partisë politike Zyra njoftohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas bërjes së ndryshimeve.

Neni 4 Shqyrtimi i kërkesave

4.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrim, mos regjistrimin, ose duke saktësuar fusha tjera që mund të kenë sqarime shtesë.

4.2 Zyra i shqyrton kërkesat brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre.

4.3 Nëse kërkesa është e pakompletuar apo nëse nevojiten të dhënat shtesë për shqyrtimin e kërkesës, Zyra do të kërkoj nga kërkuesi që të siguroj të dhënat shtesë brenda pesë (5) ditëve nga marrja e kërkesës nga Zyra.

4.4 Nëse zyra e pranon si të kompletuar kërkesën e partisë politike që është paraqitur për regjistrim, e shpallë atë në gjuhët zyrtare në Kosovë, në një apo më shumë gazeta me tirazh më të madh po ashtu edhe në faqen zyrtare të internetit të KQZ brenda shtatë (7) ditëve të punës.

4.5 Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 të kësaj Rregulle me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfarëdo të dhëne apo materiali që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga shpallja e kërkesës nga neni paraprak 4.4 të kësaj Rregulle.

4.6 Nëse nuk ka kundërshtime nga neni 4.4 dhe Zyra konstaton se nuk ka arsye për refuzimin e regjistrimit nga neni 5 i kësaj Rregulle, Zyra brenda tre (3) ditëve i rekomandon KQZ-se për regjistrimin e partisë politike, dhe për këtë e njofton partinë.

4.7 Nëse ka kundërshtime sipas nenit 4.5 të kësaj Rregulle Zyra e shqyrton kundërshtimin dhe merr vendim për miratimin apo refuzimin e kërkesës brenda tri ditëve (3) nga skadimi i afatit shtatë (7) ditësh. Nëse Zyra e miraton kërkesën, i rekomandon KQZ-së regjistrimin e partisë politike dhe njofton Partinë për vendimin.

4.8 Pas vendimit të KQZ-së Zyra menjëherë e njofton partinë politike të paraqitur për regjistrim lidhur me refuzimin e kërkesës së saj dhe konstaton se ekzistojnë një apo më shumë arsye për refuzim nga neni 5 i kësaj Rregulle..

4.9 Njoftimi për refuzimin e kërkesës për regjistrim që i dërgohet partisë politike të paraqitur për regjistrim përfshin arsyet me shkrim për refuzimin dhe informon kërkuenin për të drejtën e tij që të ankohet sipas nenit 8 të kësaj Rregulle

Neni 5

Arsyet për refuzimin e regjistrimit

5.1 Zyra e refuzon kërkesën e partisë politike për regjistrim nëse:

(a) Dokumentet e regjistrimit, duke përfshirë edhe statutin e partisë, nuk i plotësojnë kërkesat e kësaj Rregulle ose janë në kundërshtim me ligjin në fuqi.

(b) Partia shkel nenin 16.2 dhe 16.3 të kësaj Rregulle

(c) Partia paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që sipas vlerësimit të Zyrës, mund të nxisë urrejtje apo dhunë ndëretnike apo religjioze.

(d) Partia paraqitet për regjistrim me emër, akronim ose simbol që është i njëjtë dhe sipas vlerësimit të Zyrës, tepër i ngjashëm me emrin, akronimin ose simbolin e partisë të regjistruar më herët nga Zyra. Nëse dy parti paraqiten për regjistrim me emër, akronim apo me simbol të njëjtë a shumë të ngjashëm, Zyra vendos se cila prej tyre ka të drejtë të regjistrohet me emrin apo simbolin e saj, duke marrë parasysh rrethanat e përgjithshme si:

(i) datën kur secila parti e ka dorëzuar kërkesën;

(ii) datën kur secila parti e ka përdorur se pari emrin ose simbolin e saj (dhe)

Neni 6
Pezullimi i partive të regjistruara politike

6.1 KQZ-ja e pezullon nga regjistri partinë politike nëse partia:

- (a) nuk e ka informuar Zyrën në pajtim me nenin 13.5 të kesaj Rregulle se e ka mbajtur kuvendin zgjedhor brenda gjashtë (6) muajve nga regjistrimi ose brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve, nga kuvendi i fundit zgjedhor;
- (b) nuk i dorëzon Zyrës të dhënat e përditësuara të kompletuara vjetore ose raportin financiar një herë në vit, në pajtim me nenin 10, përkatësisht nenin 20 të kesaj Rregulle.
- (c) e miraton statutin ose programin e partisë që nuk përputhet me kërkesat e kesaj Rregulle;
- (d) shkel nenet 16.2, 16.3, 22.3 të kesaj Rregulle
- (e) nuk e paguan gjobën e shqiptuar nga KQZ-ja ose Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) brenda afatit të zbatueshëm ose
- (f) Kontribuesit nuk ia kthen kontributin që nuk është i lejuar, ose nuk e derdh atë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, siç parashihet në nenet 17.7 dhe 17.8 të kesaj Rregulle.

6.2 Zyra menjëherë pas pezullimit të regjistrimit të partisë politike:

- a) në regjistrin e partive politike shënon pezullimin e saj;
- b) e informon partinë politike me shkrim për hapat e nevojshëm për ta kthyer regjistrimin e partisë në gjendje të rregullt, si dhe për të drejtën e saj për të ushtruar ankesë kundër pezullimit nga neni 8 të kesaj Rregulle.

6.3 Pezullimi i regjistrimit të partisë politike mbetet në fuqi duke pritur vendimin e ankesës nga neni 8 të kesaj Rregulle.

6.4 Partia politike, regjistrimi i së cilës është pezulluar nuk merr asnjë financim publik dhe nuk certifikohet nga KQZ-ja për të marrë pjesë në zgjedhje.

6.5 KQZ e shfuqizon pezullimin e regjistrimit të partisë politike menjëherë pas plotësimit të kërkesave të Zyrës dhe të evitimit të arsyeve që kanë shërbyer si bazë për pezullim.

Neni 7
Çregjistrimi i partive politike nga regjistri

7.1 Me rekomandim të KQZ-së, Zyra e çregjistron partinë politike nga regjistri i partive politike nëse:

- a) Sanksioni penal kundër subjektit politik të regjistruar do të thotë çregjistrim i atij subjekti politik siç përcaktohet nga gjykata.
- b) Partia politike e regjistruar i cila në Zyrë nuk dorëzon formularin për ta vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik; Në rast të dështimit për tu reregjistruar në përputhje me këtë Rregulle do të konsiderohet se partia do të largohet nga regjistri i partive politike

- c) nuk është certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në tri zgjedhje të njëpasnjëshme;
- d) vullnetarisht është shpërndarë në pajtim me statutin e saj.
- e) ka qenë e pezulluar sipas nenit 6 për katërdhjetë e tetë (48) muaj të njëpasnjëshëm;
- f) I është ndaluar pune nga gjykata kompetente

7.2 Partisë politike e cila është çregjistruar nga regjistri i partive politike në pajtim me nenin 7.1 i pushon statusi i personit juridik dhe konsiderohet e shpërndarë me qëllim të kalimit të pasurisë së saj në pajtim me statutin.

Neni 8 Ankesat - Regjistrimi

8.1 Partia politike mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit të KQZ-se me të cilin refuzohet kërkesa e saj për regjistrim, bashkim ose pezullim regjistrimi në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) brenda njëzet e katër orëve (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.

Neni 9 Njoftimi për ndryshimet

9.1 Partia e regjistruar politike e njofton Zyrën brenda pesë (5) ditëve të punës nëse ajo:

- (a) e ndryshon emrin e saj zyrtar, akronimin ose simbolin. Ndryshimet e tilla do të koordinohen paraprakisht me Zyrën, duke marrë parasysh kërkesat nga neni 5 (c) dhe (d) të kesaj Rregulle;
- (b) e ndryshon statutin apo programin e saj politik;
- (c) e ndërron kryetarin, zyrtarin për financa të partisë ose anëtarësinë e organit të saj më të lartë ekzekutiv;
- (d) shpërndahet vullnetarisht;
- (e) e ndryshon identitetin, adresën apo numrin e telefonit të personit për kontaktim, përfaqësuesit financiar ose përfaqësuesit të partisë në çdo komunë ku partia është aktive;
- (f) hap apo mbyll një degë të partisë.

9.2 Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të paraparë në nenet 9.1 (a) deri në (d) të kesaj Rregulle dorëzon kopjen e procesverbalit të mbledhjes ose të procedurës me të cilin është miratuar ndryshimi, e cila duhet të jetë e vërtetuar nga kryetari i partisë.

9.3 Partia e regjistruar politike, së bashku me njoftimin për çdo ndryshim të statutit apo programit politik të partisë i dorëzon Zyres kopjen e statutit apo të programit politik të ndryshuar.

Neni 10

Të dhënat e përmbledhjeve vjetore

Partia e regjistruar politike i kompletton dhe ia dorëzon Zyrës të dhënat e përmbledhura vjetore deri më 31 janar të çdo viti duke identifikuar;

- (a) emrat dhe adresat aktuale të kryetarit të partisë, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv, të personit për kontaktim, të përfaqësuesit financiar dhe të përfaqësuesit të partisë në çdo komunë ku partia është aktive;
- (b) adresat aktuale të të gjitha degëve lokale të partisë në Kosovë dhe jashtë sajë;
- (c) çdo ndryshim të statutit apo të programit politik të partisë që është bërë gjatë vitit paraprak.

Neni 11 Bashkimet

11.1 Dy ose më shumë parti politike mund të paraqesin kërkesë për bashkim për të formuar parti të re duke i dorëzuar Zyrës:

- (a) procesverbalet e mbledhjeve apo të procedurave ku janë marrë vendimet për bashkim nga secila parti politike që merr pjesë në bashkim të nënshkruar nga secili kryetar përkatës i partisë dhe
- (b) informatat apo dokumentet e parapara në nenin 3.1 (a), (b) dhe (e) të kësaj Rregulle për partinë e re.

11.2 Kërkesa për bashkim shqyrtohet nga Zyra në mënyrë të njëjtë dhe brenda afatit të njëjtë kohor sikurse kërkesa për regjistrim të partisë politike të paraparë në nenin 3 dhe 4 të kësaj Rregulle.

11.3 KQZ me rekomandimin e Zyres e miraton kërkesën për bashkim nëse kërkesa është në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe menjëherë:

- (a) e njofton partinë e re politike me shkrim për miratimin e bashkimit;
- (b) i heq emrat e partive të bashkuara nga regjistri i partive politike dhe
- (c) i shënon emrat e partisë së re politike në regjistrin e partive politike.

11.4 Bashkimi ndërmjet dy apo më shumë partive politike fuqizohet në datën kur miratohet kërkesa për bashkim dhe kur regjistrohet nga Zyra. Lidhur me këtë Zyra e njofton partinë e re menjëherë.

11.5 Pas regjistrimit të bashkimit nga Zyra

- (a) e tërë pasuria dhe borxhet e Partive të bashkuara politike shndërrohen në pasuri dhe në borxhe të partisë së re politike dhe
- (b) të gjithë anëtarët e partive të bashkuara politike bëhen anëtarë të partisë së re politike.

11.6 KQZ-ja me rekomandimin e Zyres e refuzon kërkesën për bashkim kur nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni. Zyra e njofton parashtruesin e kërkesës me shkrim menjëherë pasi e

refuzon kërkesën për bashkim. Njoftimi i tillë përfshin arsyet për refuzimin dhe parashtruesin e kërkesës e njofton për të drejtën e tij në ankesë sipas nenit 8 të kësaj Rregulle.

Neni 12 Statuti i partisë

12.1 Çdo parti e regjistruar politike ka statutin me të cilin rregullohen veprimet e partisë si tërësi, duke përfshirë edhe degët e saj.

12.2 Statuti i partisë së regjistruar politike përfshin:

- (a) procedurat përmes të cilave qytetarët mund të bëhen anëtarë dhe të pushojnë të jenë anëtarë të partisë, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
- (b) procedurat që duhet zbatuar për ndryshimin e statutit ose programit politik të partisë;
- (c) procedurat që duhet zbatuar nga partia për shpërndarjen e saj, hyrjen në koalicion elektoral apo bashkimin me parti tjetër;
- (d) procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kryetarit, të anëtarëve të organit më të lartë ekzekutiv ose të zyrtarëve të tjerë të zgjedhur të partisë;
- (e) procedurat që duhet zbatuar për zgjedhjen e kandidatëve të partisë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe të kuvendeve komunale duke marrë parasysh nenin 14;
- (f) krijimin e një organi për zgjidhjen e kontesteve brenda partisë lidhur me interpretimin e statutit;
- (g) kalimin e gjithë pasurisë së mbetur pas shlyerjes së të gjitha borxheve me rastin e shpërndarjes së partisë dhe
- (h) kohëzgjatjen dhe rregulloren e punës që duhet zbatuar në kuvendet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të anëtarëve të partisë, duke përfshirë edhe sigurimin e kuorumit, rendit të ditës dhe të vendimmarrjes.

12.3 Ndryshimi në statutin e partisë së regjistruar politike që nuk përputhet me kërkesat e kësaj Rregulle është i pavlefshëm.

12.4 Çdo parti e regjistruar politike dhe të gjithë anëtarët e saj, organet ekzekutive dhe zyrtarët e saj duhet t'i përmbahen statutit të partisë dhe kur statuti nuk është në përputhje me këtë Rregull, ata u përmbahen kushteve të kësaj Rregulle.

12.5 Statuti i partisë së regjistruar politike është dokument publik dhe me kërkesë të qytetarëve partia bën kopje të statutit të saj aktual. Partia mund të caktojë taksën e cila nuk tejkalon vlerën prej njëzet e pesë eurocentëve (0,25 eurocentë) për një faqe të kopjes së statutit.

Neni 13 Kuvendi

13.1 Partia e regjistruar politike mban kuvendin brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku çdo tridhjetë e gjashtë (36) muaj.

13.2 Kryetari i partisë së regjistruar politike raporton mbi gjendjen financiare të partisë dhe paraqet raport financiar për gjashtëmujorin midis dy kuvendeve.

13.3 Kuvendi i partisë së regjistruar politike zgjedh kryetarin, organin më të lartë ekzekutiv të partisë në mënyrë demokratike dhe transparente brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku çdo tridhjetë e gjashtë (36) muaj.

13.4 Secili anëtar i partisë së regjistruar politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes delegatit të caktuar sipas procedurës përkatëse, ka votë të barabartë në të gjitha vendimet e marra nga kuvendi, duke përfshirë zgjedhjen e kryetarit dhe të organit më të lartë ekzekutiv të partisë.

13.5 Partia e regjistruar politike e informon Zyrën se ka mbajtur kuvendin e fundit jo me vonë se pesë (5) ditë pas mbajtjes së tij, me dorëzimin e kopjes së procesverbalit të kuvendit. Saktësia e procesverbalit vërtëtohet nga kryetari i partisë.

13.6 Partia e regjistruar politike duhet ta ftojë "Zyrën" për ta vëzhguar Kuvendin. Partia Politike e regjistruar duhet ta ftojë Komisionin Komunal të Zgjedhjeve për të vëzhguar Kuvendin e degës së saj përkatëse.

Neni 14

Zgjedhja e kandidatëve elektorale

14.1 Partia e regjistruar politike siguron pjesëmarrje demokratike të anëtarëve të partisë në zgjedhjen e kandidatëve elektorale të partisë.

14.2 Kandidatët e partisë së regjistruar politike në zgjedhjet për kuvendin komunal zgjedhen nga dega apo degët e partisë në atë komunë.

Neni 15

Anëtarët e partisë politike

15.1 Personi duhet të ketë të drejtë vote në Kosovë për të qenë anëtar i partisë politike.

15.2 Partia e regjistruar politike mban dhe kujdeset për regjistrin e anëtarëve i cili përfshin emrat, adresat dhe regjistrimin civil, numrat e pasaportës apo të patentë shoferit të të gjithë anëtarëve të saj, si dhe datat e anëtarësimit të tyre.

15.3 Partia e regjistruar politike mund të caktojë pagesën ose taksën për anëtarët e saj e cila nuk kalon shumë prej dymbëdhjetë (12) eurosh për anëtar brenda një viti kalendarik.

15.4 Anëtarët e partisë së regjistruar politike, duke përfshirë zyrtarët e saj, nuk janë përgjegjës për borxhet e partisë.

Neni 16

Zyrtarët e partive politike

16.1 Kryetari dhe të gjithë zyrtarët tjerë të partisë së regjistruar politike duhet të jenë anëtarë të partisë.

16.2 Personi i cili është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë apo i cili është i akuzuar nga gjykata dhe nuk i është përgjigjur urdhërit për paraqitje në gjykatë nuk mund të mbajë asnjë post apo funksion në kuadër të partisë politike apo ta përfaqësojë atë.

16.3 Avokati e popullit dhe zëvendësit e tyre ose ndonjë person tjetër nga grup i personave të përmendur në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk mund të emërohen, të zgjedhen apo të mbajnë ndonjë funksion tjetër të partisë politike apo ta përfaqësojnë atë.

16.4 Organi më i lartë ekzekutiv i partisë së regjistruar politike autorizon një apo më shumë persona të cilët janë të autorizuar të bëjnë marrëveshje në emër të partisë.

Neni 17 Financimi i partive politike

17.1 Partia e regjistruar politike nuk merr asnjë lloj kontributi përpos:

- (a) kontributeve nga personat jo më shumë se njëzet mijë euro (20.000) për vit kalendarik për një person po qe se kontributet në të holla i plotësojnë kërkesat nga neni 5 i Rregullores 2004/2 mbi (“Shperlarjen e parave”)
- (b) pagesave për anëtarësi nga anëtarët e partisë në përputhje me statutin e partisë dhe
- (c) financimit apo përkrahjes tjetër nga Buxheti i Kosoliduar i Kosovës sipas nenit 18 të kësaj Rregulle.

17.2 Partia politike nuk pranon kontribute nga personi i cili para dhënies së kontributit nuk ia tregon partisë:

- (a) emrin e plotë;
- (b) adresën dhe
- (c) numrin personal (*numrin e pasaportës ose numrin e patentë shoferit*).

17.3 Partia e regjistruar politike nuk pranon kontribute të dhëna në mënyrë të tërthortë përmes një personi, nga paratë, pasuria apo shërbimet e palës së tretë.

17.4 Partia e regjistruar politike nuk mund të hyjë në asnjë lloj veprimtarie financiare apo fitimprurëse, përpos shitjes së të mirave siç janë publikimet ose posterët me emblemën apo akronimin e partisë në shumë të përgjithshme jo më të madhe se dy mijë (2.000) euro në vit.

17.5 Pasuria dhe të hyrat e partisë së regjistruar politike përdoren vetëm për përkrahjen e qëllimeve jofitimprurëse politike të partisë dhe nuk përdoren për qëllime fitimprurëse në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të cilitdo zyrtari partiak, anëtar, donatori ose qytetari. Ky nen nuk parandalon pagesën e një kompensimi të arsyeshëm për punën e kryer për partinë e regjistruar politike e cila pasqyrohet në raportin financiar zyrtar, në pajtim me nenin 20 të kësaj Rregulle.

17.6 Çdo pagesë në të holla nga ana e partisë së regjistruar politike në të mirë të marrësit bëhet në pajtim me nenin 5 të Rregullores 2004/2 mbi (“Shperlarjen e parave”)

17.7 Nëse partia e regjistruar politike pranon kontributin që nuk është i lejuar sipas kësaj Rregulle, kryetari i partisë ia kthen kontributin kontribuesit brenda katërmëdhjetë ditësh (14) nga koha e marrjes së informatës për kontributin e palejueshëm.

17.8 Nëse partia e regjistruar politike nuk është në gjendje t'ia kthejë kontributin e palejueshëm kontribuesit brenda katërbëdhjetë (14) ditësh nga marrja e informatës për kontributin e palejueshëm, kryetari i partisë e kthen kontributin menjëherë në Buxhetin e Kosovës në pajtim me procedurat që caktohen nga Zyra në konsultim me Qeverinë.

Neni 18

Financimi publik i partive të regjistruara politike

18.1 Partia e regjistruar politike mund të pranojë financime të drejtpërdrejta si dhe ndihma të tjera nga Buxheti i Kosovës po që se ndihma e tillë financiare:

(a) është e autorizuar me ligjin në fuqi dhe

(b) u është ndarë pranuesve duke u bazuar në kriteret e zyrtarizuara nga Kuvendi i Kosovës.

18.2 Financimi publik i partisë së regjistruar politike nga Buxheti i Kosovës shpërndahet në atë mënyrë që të mos bëhet dallim i vendeve të parapara për bashkësitë joshqiptare të Kosovës.

18.3 Partia politike që nuk arrin ta zgjedh kryetarin e saj dhe organin më të lartë ekzekutiv dhe për këtë nuk e informon Zyrën sipas nenit 13 nuk ka të drejtë dhe nuk do të pranojë asnjë lloj financimi publik derisa nuk i përmbush kushtet sipas këtyre neneve.

Neni 19

Përfaqësuesi financiar

19.1 Përfaqësuesi i autorizuar financiar i Partisë së regjistruar politike është e vetmja pikë kontakti ndërmjet Zyrës dhe partisë lidhur me të gjitha çështjet financiare.

19.2 Zyrta i autorizuar financiar i partisë dhe kryetari i partisë janë ligjërisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha informative të dorëzuara në Zyrë, ashtu siç kërkohet me Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme.

Neni 20

Raportet financiare vjetore

20.1 Partia e regjistruar politike ia dorëzon Zyrës për çdo vit raportin vjetor financiar për periudhën 1 janar deri më 31 dhejtor, më së largu deri me 1 mars të vitit vijues në mënyrën e paraparë nga Zyra:

20.2 Secili raport financiar vjetor përmban:

(a) bilancin e gjendjes i cili tregon pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët a para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport.

(b) pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj gjatë periudhës së përfshirë në raport dhe

(c) pasqyrën e cila tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesë mijë (5.000) euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.

20.3 Çdo raport financiar vjetor përmban kopjet e dokumentacionit vijues:

(a) pasqyrën financiare të partisë së regjistruar politike për periudhën e përfshirë në raport;

(b) faturat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind (100) eurosh;

(c) bilancet bankare për çdo llogari bankare të partisë së regjistruar politike apo llogarive në emër të saj dhe

(d) regjistrin e të gjitha kontributeve për partinë e regjistruar politike të dhëna nga një burim i vetëm, nëse vlera e përgjithshme e kontributeve nga ai burim ka tejkalar shumën prej njëqind (100) eurosh gjatë periudhës së përfshirë në raport, i cili tregon:

- (i) vlerën e secilit kontribut të dhënë partisë;
- (ii) datën kur është dhënë secili kontribut dhe
- (iii) emrin e plotë, adresën dhe numrin personal, të pasaportës apo të patentë shoferit të kontribuesit.

Neni 21 Evidencat

21.1 Secila parti e regjistruar politike mban dhe përditëson shënime financiare të sakta dhe të hollësishme për një periudhë shtatëvjeçare (7), duke përfshirë:

(a) librat e kontabilitetit të cilat në pajtim me parimet përgjithësisht të pranura regjistrojnë:

- (i) burimin e të gjitha të hyrave, shumën dhe mënyrën e pagesës, me të holla, përkatësisht me urdhërpagesë dhe
- (ii) të gjitha pagesat e bëra të partisë ndaj secilit person, qëllimin e pagesës dhe mënyrën e pagesës;

(b) faturat e të gjitha shpenzimeve që tejkalojnë shumën prej njëqind (100) eurosh;

(c) shënimet bankare për të gjitha llogaritë e partisë apo llogaritë në emër të saj;

(d) dokumentet që përcaktojnë bazën ligjore për pronësi apo për zotërim të pasurisë së patundshme ku gjendet partia;

(e) kontratat, duke përfshirë kontratat lidhur me dhënien me qira apo blerjen e pasurisë së patundshme apo të pasurisë personale;

(f) regjistrin e të gjithë anëtarëve të partisë dhe

(g) evidencat për të gjitha kontributet për partinë, duke përfshirë:

- (i) vlerën e secilit kontribut të dhënë për partinë;
- (ii) datën e dhënies së secilit kontribut;
- (iii) emrin e plotë, adresën dhe numrin personal, e pasaportës apo të patentë shoferit të secilit kontribues dhe
- (iv) emrin e përfaqësuesit të partisë i cili ka pranuar kontributin në emër të partisë.

Neni 22 Kontrollimi i raporteve financiare

22.1 Zyra e bënë kontrollimin e secilit raporti financiar vjetor.

22.2 Zyra kryen kontrollimin në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshëm në Kosovë.

22.3 Partia e regjistruar politike bashkëpunon ngushtë me revizorët e Zyrës dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të partisë, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.

22.4 Zyra ia paraqet rezultatet paraprake të kontrollimit të raportit vjetor financiar organit më të lartë ekzekutiv të partisë politik, duke përfshirë edhe listën e gabimeve apo lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit.

22.5 Partia e regjistruar politike brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm apo lëshim të identifikuar nga Zyra.

22.6 Zyra përgatit raportin përfundimtar të revizionit partisë së regjistruar politike brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga dorëzimi i raportit paraprak të revizionit. Raporti përfundimtar identifikon çdo gabim apo lëshim në raportin financiar, duke marrë parasysh çdo shpjegim apo rishikim të dorëzuar sipas nenit 22.5 të kësaj Rregulle.

22.7 Pas kryerjes së raportit përfundimtar të kontrollimit, Zyra ia dorëzon një kopje të organit më të lartë të partisë së regjistruar politike.

Neni 23

Qasja në dokumentet e Partive Politike

23.1 Zyra azhuron dhe mirëmban dokumentet e Partive Politike:

- (a) regjistrit të partive politike;
- (b) statutit të secilës parti të regjistruar politike;
- (c) programit politik;
- (d) versioneve përfundimtare të të gjitha raporteve financiare vjetore të dorëzuara në Zyrë;
- (e) të gjitha raporteve përfundimtare të revizimit të lëshuara nga Zyra.
- (f) regjistrit të donatorëve që tregojnë:

- (i) emrin e plotë dhe numrin personal, pasaportës apo të patentë shoferit të të gjithë personave që kanë dhënë kontribut për partinë e regjistruar politike, vlera e përgjithshme e të cilave gjatë vitit kalendarik ka kaluar shumë prej njëqind (100) eurosh;
- (ii) identitetin e partisë së regjistruar politike pranuese të donacionit;
- (iii) vlerën e kontributeve dhe
- (iv) datat e dhënies së kontributeve;

23.2 Qasja në dokumentacionin e regjistrimit të Partive Politike bëhet konform Rregullave të Ligjit mbi Qasjen e Dokumentave Zyrtare.

Neni 24

Gjobat

24.1 KQZ, sanksionon partitë e regjistruara politike për shkelje të kësaj Rregulle bazuar në rregullën e KQZ 14/2008 "Sanksionet dhe Gjodat. Rastet të cilat mund të nënkuptojnë ndonjë veprim kriminal do të përcillen nga KQZ-ja në Zyren e Prokurorit të Kosovës.

24.2 Nëse KQZ-ja ia shqipton gjobën partisë së regjistruar politike, ajo menjëherë e njofton partinë për gjobën dhe për të drejtën në ankesë sipas nenit 8 brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga marrja e këtij njoftimi.

24.3 Shqiptimi i gjobës nuk ndikon në pezullimin e regjistrimit të partisë politike sipas nenit 6 të kësaj Rregulle.

24.4 Shqiptimi i gjobës nuk paragjykon asnjë sanksion penal që mund të zbatohet. Rastet të cilat mund të nënkuptojnë vepër penale do të përcillen nga KQZ-ja në Zyren e Prokurorit të Kosovës.

24.5 Gjodat e mbledhura Zyra i kthen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

24.6 Zyra mund të parashtojë ankesë në PZAP përveç në rastet kur Partia Politike nuk i paguan gjodat në pajtueshmëri me nenin 24.1 të kësaj rregulle me afatin e përcaktuar.

Neni 25

Zgjatja e periudhës së dorëzimit të dokumenteve

25.1 Zyra mund të lejojë zgjatjen e periudhës së dorëzimit të dokumenteve të parapara në nenet 10, 20 dhe 22 pas dorëzimit të kërkesës me shkrim të partisë së regjistruar politike për një zgjatje të tillë. Kërkesa dorëzohet jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas kalimit të afatit të paraparë për dorëzimin e dokumenteve dhe përmban sqarimin për atë se partia nuk ka mundur të përmbushë afatin për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të saj. Zyra e njofton me shkrim partinë për vendimin e saj nëse ka lejuar zgjatjen e periudhës së dorëzimit të dokumenteve brenda pesë (5) ditëve të punës nga pranimi i kërkesës.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike dhe hyn në fuqi më 25.06.2010

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
